



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Fjala e Ministres Gjermani mbi Lancimin e Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë.

2017-05-17 15:06:00



Mirëmëngjes,
Falenderime

- Sot së bashku me Ambasadën e Zvicrës organizojmë aktivitetin prezantues të “Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”, faza e tretë, me bashkëfinancues qeverinë Zvicerane dhe atë Austriake me Grantin në vlerë **tre pikë dy milionë Euro**.
- Dua të përfitoj nga rasti t’i shpreh falenderimet e mia të dy miqve të mi dhe miqve të Shqipërisë Ambasadorit të Zvicrës z. Christoph Graf dhe Ambasadorit të Austrisë z. Johann Sattler, për mbështetjen e pakursyer që i kanë ofruar zhvillimit të qëndrueshëm të vendit me projekte konkrete. Gjithashtu dua t’i falënderoj për zëmërsisht për kontributin e dhënë në rrugëtimin e Shqipërisë për tu bërë, në një të ardhme të afërt, vend anëtar i Bashkimit Evropian.

Procesi

- Ky program, marrëveshja për financimin e të cilit u nënshkrua në Zvicër më 29 mars të këtij viti, tashmë e miratuar edhe në Kuvendin e Shqipërisë, është në thelb një platformë pune me impakt të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe teknike, përmirësimit të kuadrit ligjor për zhvillimin rajonal, dhe mbi të gjitha realizimit të projekteve konkrete ndërvendore.
- Një mundësi më shumë, për zhvillimin social dhe ekonomik të qëndrueshëm të zonave ku do të jetësohen projektet konkrete, si dhe në forcimin e kapaciteteve teknike dhe institucionale të katër Agjencive të Zhvillimit të Rajoneve.

Reforma territoriale dhe rajonale

- Reforma administrative territoriale, një histori sukseesi e reformave të ndërmarra gjatë këtij çerek shekulli në vend, ka krijuar struktura vendore më efikase, si dhe ka ofruar një mekanizëm dinamik për fuqizimin e hapësirave ekonomike, sociale dhe kulturore, nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet njësive administrative kufitare, por edhe në kuadër të rritjes së konkurrueshmërisë ndërmjet tyre.
- Në zemër të këtij programi qëndron një vizion i qartë i rëndësisë që ka zhvillimi rajonal, si një proces efikas për një zhvillim të barabartë dhe të qëndrueshëm social ekonomik, në të gjithë territorin e vendit.
- Menjëherë pas konstituimit të 61 bashkive të reja, në shtator të vitit 2015 u miratuan katër zonat e zhvillimit rajonal, duke i hapur rrugën krijimit të katër agjencive të zhvillimit rajonal me seli në Shkodër, Tiranë, Korçë dhe Vlorë.
- Duke e konsideruar zhvillimin e vendit si një të tërë, ky riformatim i ri i ndarjes në katër rajone, është një mundësi më shumë për bashkitë apo zonat me tipare të përbashkëta zhvillimi, të rrisin dhe promovojnë avantazhet e tyre konkurruese, nëpërmjet bashkëpunimit dhe zbatimit të projekteve ndërvendore.
- Kjo politikë e përbashkët investimesh i shërben forcimit të bashkëpunimit dhe punës në ekip ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore apo edhe njësive vendore me njëra – tjetrën.

Vizioni i këtij programi

Dhe do të jetë pikërisht ky vizion që do të jetësohet falë zbatimit të Programit të Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë faza 3, ndërhyrjet e të cilit përqendrohen në:

1. Kuadrin ligjor dhe hartimin apo përmirësimin e politikave kombëtare për zhvillimin rajonal;
2. Rritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale të katër agjencive të zhvillimit rajonal, Ministrisë së Zhvillimit Urban si institucion lider për zbatimin e kësaj marrëveshje, por edhe si institucioni përgjegjës për hartimin e instrumenteve dhe dokumenteve kombëtare të planifikimit; si dhe
3. Në ofrimin e granteve për zbatimin e projekteve konkrete ndërvendore për zhvillimin rajonal.

Çfarë kemi bërë në këtë mandat të parë

- Sigurisht, që nismat e konkretizuara tashmë në produkte konkrete në fushën e **planifikimit** kombëtar dhe vendor, apo edhe të 400 projektet e financuara dhe zbatuara nga qeveria Shqiptare, në kuadër të **Programit Kombëtar Rilindja Urbane** në të 61 bashkitë e vendit, kanë lehtësuar dhe forcuar bashkëpunimin dhe konkurrencën ndërvendore.

Në harkun kohor të këtyre tetëmbëdhjetë muajve, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, ka miratuar mbështetjen financiare të 3 projekteve të zbatimit të hartuara nga agjencitë e zhvillimit rajonal, si më poshtë vijon:

- Sistemimi me interes turistik dhe kulturor si: shtigjet, udhët dhe itineraret turistike, ndërmjet bashkive Tiranë dhe Klos në zonën Pëllumbas - Shën Gjergj - Mali me gropa - Bizë - Gur i Bardhë - Lugina e Vashës me vlerë **tetëmbëdhjetë milionë lekë**;
- Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse Qafështamë - Burrel, me qëllim promovimin e atraksioneve turistike të Parkut Kombëtar të Qafështamës, me vlerë financimi **njëqind e tridhjetë e tre milionë lekë** dhe
- Rigjallërimi i vlerave historike, kulturore e turistike të Zonës së Zhvillimit Rajonal 3, Korçë – Elbasan me vlerë financimi **njëqind e dyzet e tetë milionë lekë**

Ndërkohë që në thirrjen e II – të për vitin 2017 të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve të katër agjencitë rajonale kanë përfituar fonde për hartimin e 22 projekteve të reja, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës urbane, ndërhyrjeve rigjeneruese në zonat me potenciale natyrore, kulturore dhe historike në funksion të zhvillimit social-ekonomik të zonës dhe veçanërisht sektorit të turizmit.

● **Mbyllje**

Dua të falënderoj Qeverinë Zvicerane, e cila krahas këtij Programi është gjithashtu duke na ofruar mbështetje teknike dhe financiare në procesin e hartimit të planeve vendore në 5 bashki Malësi e Madhe, Tropojë, Vau i Dejës, Mat dhe Klos.

Zbatimi i këtij programi është një mundësi më shumë në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe një instrument tjetër financiar për zbatimin e projekteve konkrete, duke i kthyer bashkitë në motorr që gjenerojnë më shumë mundësi punësimi, mirëqenie për qytetarët, rritje ekonomike të sipërmarrjeve ekzistuese dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ju faleminderit!